

Ky hulumtim ka për qëllim që të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes së diasporës në proceset zgjedhore në Kosovë përmes shqyrtimit të praktikave të votimit jashtë vendit në shtetet e tjera, studimit të barrierave të diasporës për të votuar dhe vendosjes së politikave efektive për të lehtësuar votimin nga jashtë.

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) bashkë me Demokraci Plus (D+) kanë hartuar këtë raport për të paraqitur gjendjen e tanishme dhe për të analizuar dilemat e politikave dhe rezultatet që mund të rezultojnë nga vendime të ndryshme.

Për këtë dokument janë mbajtur konsultime publike edhe me përfaqësues të diasporës.